



A.nr.682/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.682/2025 të datës 18.04.2025, të parashtruar nga ankuesi M.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Ardian Megjani, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.682/2025, e datës 18.04.2025, e parashtruar nga ankuesi M.A.

II. Anulohet në tersi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me Numër Reference: RN00016511, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, M.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 18.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016511, për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv”, i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit ndërsa kjo e fundit më datë 14.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, përmes Vendimit me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3636/2025 të datës 29.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.682/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 2585/2025 të datës 18.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Autorizimin e datës 17.04.2025; Vërtetimin e punësimit me numër protokoli 1126 të datës 14.02.2025; Listën e aplikantëve të konkursit me numër reference RN00015490; Vendimin DE 513/2024 të datës 11.12.2024; Listën e aplikantëve të konkursit me numër reference RN00016511; Njoftimin e datës 04.04.2025; Publikime të portaleve; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.05.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 14.05.2025; Vendimin Nr.Ref.BD-210/3; Konkursin me numër reference RN00016511; Aplikacioni i ankuesit i datës 17.02.2025, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin i kandidatit B.S, i datës 26.02.2025, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacioni i kandidates K.B, i datës 23.02.2025, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacioni i kandidates N.K, i datës 25.02.2025, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin i kandidatit S.V, i datës 07.02.2025, së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit Xh.D, i datës 31.01.2025 së bashku me shkresat e bashkangjitura për konkursin përkatës; Vendimin e datës 19.03.2025; Aneks akt emërimit me numër 05/ZDE 1 të datës 02.12.2024; Vendimin Nr.Ref.BD-214/2 të datës 15.11.2024; Akt emërimit me numër reference: 03/ZDE FP-1 të datës 02.09.2025; Vendimin me Nr.08-V-172 të datës 24.12.2021; Vendimin me Nr.06/172 të datës 08.11.2023; Kontratat e punës të B.B; Akt emërimit me numër reference 10/DKL 9 të datës 12.02.2024; Ftesat për testin me shkrim; Testet me shkrim të kandidatëve; Formularët vlerësimit të eses; Ftesat për intervistën me gojë; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 02.04.2025; Njoftimin e listës së kandidatëve fituese të datës 04.04.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Agjencia Kosovare e Privatizimit, me datë 27.01.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016511, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me afat aplikimi nga data 28.01.2025 deri më datë 26.02.2025, ku sipas sipas pikës 3 të këtij konkursi, kërkesa të përgjithshme formale, kanë qenë këto:

- **a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomat nga universitetet e huaja duhet jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

- **b) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijmë:

c.1.) pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

c.2.) katër (4) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

c.3.) tre (3) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoratës).

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, ku prej tyre gjashtë (6) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin, i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit duke arritur gjithsejtë 75.2 pikë nga kjo procedurë rekrutimi.

Tutje, sipas Njoftimit të datës 04.04.2025 lidhur me listën e kandidatëve fitues, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rezulton se kandidatja N.K, me gjithsejtë 87.6 pikë të arritura, kandidati B.S me gjithsejtë 76.8 pikë të arritura si dhe ankuesi me gjithsejtë 75.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë si kandidat fitues për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ankuesi, ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për parregullësit ligjore në procesin e rekrutimit të lartë theksuara, apo për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar ndër të tjera se përbërja e Komisioni i Pranimit ishte në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/ /L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, se kandidatja fituese në konkursin paraprak nuk ka plotësuar kriteret për tu kualifikuar dhe se i njëjti thekson po ashtu se kandidatja fituese ushtron funksionin e Këshilltares-Asambleistes së Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës ka gjetur se Komisioni për vlerësimin profesional të kandidatëve për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv* i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është themeluar sipas Vendimit të datës 19.03.2025, të Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe se nga analizimi i këtij vendimi rezulton se kjo përbërje e këtij komisioni për vlerësimin profesional të kandidatëve në këtë procedurë rekrutimi:

- z. I.G- kryesues, i cili sipas Akt emërimit me numër Reference: 03/ZDE FP-1 të datës 02.09.2024, është emëruar Zëvendës Drejtor Ekzekutiv-Funksione të Përgjithshme në Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa sipas Vendimit me Nr.Ref.BD-214/2 të datës 15.11.2024, të Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, nga pozita e sapo theksuar është emëruar Ushtrues Detyre i Drejtorit Ekzekutiv i AKP-së, si dhe po ashtu të njëjtit më datë 02.12.2024 i është lëshuar Aneks akt i emërimit me numër 05/ZDE 1, për pozitën Drejtor Ekzekutiv i AKP-së;
- z. B.B- anëtar, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, i cili sipas Vendimit me Nr.06/172, të datës 08.11.2023, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- z. Y.B- anëtar, i cili sipas Vendimit me Nr.08-V-172 të datës 24.12.2021, të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është emëruar Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- z. B.B, anëtar/ekspert i jashtëm, i cili sipas Kontratës së Punës me Ref.Nr.719/2024 të datës 14.10.2024, rezulton se është i punësuar tek Kolegji “AAB”, në pozitën e Profesorit të Rregullt; si dhe
- z. F.M, anëtar, i cili sipas Akt emërimit me numër Reference: 10/DKL 9 të datës 12.02.2024, është emëruar Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore në AKP.

Andaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në të gjeturat e lartë theksuara, dhe me qëllim të konstatimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, i’ u referuar paragrafit 1, 2 dhe 3 të nenit 51 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *1. Nëpunësja/i civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistes/it në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të këtij ligji, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët. 2. Gjatë periudhës provuese, nëpunësja/i kryen trajnimet e detyrueshme dhe kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë. 3. Nëpunësja/i civil, gjatë periudhës provuese nuk mund të transferohet dhe nuk mund të marrë pjesë në komisione që themelohen nga institucionet për të cilat kërkohet përvojë profesionale.; paragrafit 1, 2 dhe 4 të nenit 18 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Nëpunësi civil, pas emërimit në shërbimin civil i nënshtrohet periudhës provuese që zgjat gjashtë (6) muaj. 2. Puna provuese është përgatitja teorike dhe praktike e nëpunësit për kryerjen me sukses të detyrave të pozitës ku është emëruar. 4. Nëpunësi civil gjatë periudhës provuese nuk ka të drejtë që të merr pjesë në komisionet përzgjedhëse, komisionet disiplinore, komisionet e ankesave apo që të caktohet si zëvendësues në ndonjë pozitë tjetër;,, rrjedhimisht*

Kolegji i Këshillit konstaton, se emërimi i z. I.G në pozitën e Ushtruesit të Detyrës të Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së, përmes Vendimit me Nr.Ref.BD-214/2 të datës 15.11.2024, dhe pjesëmarrja e tij si Kryesuesi i këtij Komisioni të Pranimit është në kundërshtim me këto dispozita ligjore, ngase i njëjti siç edhe u theksua më sipër me datë 02.09.2024, dhe atë sipas Akt emërimit me numër Reference: 03/ZDE FP-1, është emëruar në pozitën e Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv-Funksione të Përgjithshme në Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa ende pa kaluar periudhën provuese prej gjashtë (6) muajsh, gjegjësisht më datë 15.11.2024 është emëruar Ushtrues Detyre i pozitës për të cilën është zhvilluar procedura përkatëse e rekrutimit dhe njëkohësisht përmes Vendimit të datës 19.03.2025, konstatohet se i njëjti po në këtë cilësi gjegjësisht të Ushtruesi të Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së ka marrë pjesë në komisionin për vlerësimin e kandidatëve të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016511.

Tutje, ndërlidhur me emërimin e z. Y.B- Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, anëtar të Komisionit të Pranimit, i cili sipas Vendimit me Nr.08-V-172 të datës 24.12.2021, të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është emëruar Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Kolegji i Këshillit, i' u referuar nenit 48 paragrafit 3, ku përcaktohet se: *3. Komisioni shtetëror i pranimi për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në administratë shtetërore, apo komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 3.1. tre (3) nëpunës/ës ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese; 3.2. udhëheqësen/in e njësisë përgjegjëse; 3.3. një (1) eksperte/t i jashtëm.*; ndaj si rrjedhojë, Kolegji konstaton se pozita e Drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk është pozitë e nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese në Shërbimin Civil, sepse i njëjti nuk i nënshtrohet procedurave të rekrutimit sipas Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, apo legjislacionit të aplikueshëm për periudhën kur z. Y.B është përzgjedhur në këtë pozitë, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik, por se i njëjti në kuptim të nenit 3 paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për zyrtarët publik-Ligjit Nr.08/L-197, përkatësisht nenit 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, rezulton se është funksionar publik i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, thënë më konkretisht procedura e zgjedhjes së Drejtorit të kësaj agjencie është përcaktuar me legjislacionin e aplikueshëm të periudhës kohore të përzgjedhjes së z. Y.B, gjegjësisht me nenin 8 të Ligjin Nr.03/L- 159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, procedura e zgjedhjes për këtë pozitë është përcaktuar me nenin 11.

Andaj, referuar konstatimeve si më sipër dhe bazuar në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 48 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *2. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion tjetër shtetëror, bëhet nga komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Komisioni shtetëror i pranimi për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në administratë shtetërore, apo komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 3.1. tre (3) nëpunës/ës ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese; 3.2. udhëheqësen/in e njësisë përgjegjëse; 3.3. një (1) eksperte/t i jashtëm.*, Kolegji i Këshillit, konstaton se përbërja e Komisionit të Pranimit për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016511 për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese: Drejtor Ekzekutiv i AKP-së, i themeluar sipas Vendimit të datës 15.11.2024, të Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ka qenë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore dhe me paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit 51 të këtij ligji, si dhe me paragrafin 1, 2 dhe 4 të nenit 18 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ngase në

përbërje të komisionit të pranimi për vlerësimin profesional të kandidatëve, ka marrë pjesë një nëpunës i civil i cili ende pa kaluar periudhën provuese është caktuar Ushtrues Detyre, si rrjedhojë në cilësinë e ushtrimit të po kësaj pozite dhe përmes të njëjtit vendimi ka marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve dhe se po ashtu në përbërje të komisionit mungon një nëpunës i kategorisë lartë drejtuese i shërbimit civil.

Si rrjedhojë e konstatimeve si më sipër dhe duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 4, ku përcaktohet se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj”*, si dhe nenin 52, ku përcaktohet se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”*, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi i datës 15.11.2024, i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për themelimin e Komisionit të Pranimi për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016511 për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese: Drejtor Ekzekutiv i AKP-së, është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 4 dhe nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për faktin se Komisioni i pranimi nuk ka kompetencë ligjore për vlerësimin e kandidatëve në këtë procedurë rekrutimi për arsyet e dhëna në arsyetim të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se emërimi i Komisionit të Pranimi sipas Vendimit të datës 19.03.2025, ka bërë që procedura e rekrutimit, të zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publik, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, Rregullores Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.15/2023, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016511, për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv*, i Agjencisë së Privatizimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.682/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Ardian Megjani;
- Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.